



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:287041
Datë: 03.10.2024
Numri i dokumentit: 06246277

K.DH.Shk II.nr.1350/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, rr. “UÇK”, nr. 2, kundër debitorit “Global Pharmaceuticals” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811255513 dhe me seli në Prishtinë, rr. “Behar Begolli”, p.n., me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2211/23 të datës 28.05.2024, me datë **02.10.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2211/23 të datës 28.05.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2211/23 të datës 28.05.2024, në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar prapësimin e debitorit “Global Pharmaceuticals” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 445/23 të datës 17.08.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, është anuluar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (me pretendime sikur në ankesë), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i

Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2211/23 të datës 28.05.2024, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Ankesa e kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, mirëpo i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komuna e Prishtinës, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr. 445/23, të datës 17.08.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve; Faturës nr. 201912709, e datës 19.12.2022, duke detyruar debitorin “Global Pharmaceuticals” Sh.P.K., që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin në emër të borxhit nga fatura e lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 1,500.00 EUR (me shkronja: një mijë e pesëqind euro), si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetim se për shkak të problemeve financiare nuk është duke funksionuar dhe sa i përket faturës në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbartimor, të njëjtën nuk e ka pranuar asnjëherë. I ka propozuar gjykatës që të anulohet urdhrin përmbartimor..

Kreditori, në përgjigje ndaj prapësimin ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit për arsye se asnjëra prej tyre nuk paraqet bazë për kundërshtim sipas nenit 71 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se lidhur me pretendimin e debitorit se janë plotësuar kushtet nga neni 61, par. 1.1 të LPP-së për të goditur urdhrin përmbartimor, e ka njoftuar gjykatën se dokumenti përmbartues i nxjerrë në procedurë administrative/kundërvajtje, në përputhje me nenin 24.4 të LPP-së është bërë i përmbartueshëm sipas rregullave me të cilat rregullohet kjo procedurë. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të vërtetohet.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.2211/23 të datës 28.05.2024, ku në dispozitivin e aktvendimit e e ka pranuar prapësimin e debitorit “Global Pharmaceuticals” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 445/23 të datës 17.08.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj, është anuluar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar se dokumenti Faturë nr. 201912709 e datës 19.12.2022, në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së, për faktin se fatura e lartcekur nuk përmban nënshkrimin apo vulën e debitorit tek pranuesi i faturës, e rrjedhimisht rezulton se e njëjta nuk është pranuar me rregull nga debitori. Ndërsa, në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmoj se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme i'a ka dorëzuar debitorit, ndërsa ky i fundit ka pranuar faturën në fjalë dhe se është pajtuar më përmbajtjen dhe lartësinë e të njëjtës.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkallës së dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, konsideron se fatura me numër 201912709 e datës 19.12.2022, dokument në sajë të cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se është pranuar nga debitori, e njëjta nuk është vërtetuar e as nënshkruar nga debitori, andaj, në këtë mënyrë fatura nuk mund konsiderohen si dokument i besueshëm.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe pretendimet ankimore të kreditorit por që këto pretendime i vlerësoi si të pabazuara, pasi që në vlerësimin e Gjykatës, pasi që debitori nuk ka nënshkruar faturën mbi bazën e të cilës është lejuar përmbarimi dhe që nënkupton se nuk është pajtuar me borxhin që rrjedh nga fatura.

Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet

ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.Shk II.nr.1350/24 , me datë 02.10.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami